



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-79
Datë: 16.02.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet Qendra e Bukurisë "American Beauty" në Ferizaj dhe Gjilan, për periudhën **21.12.2016** deri **21.12.2019** për të ofruar kualifikime të validuara ne KKK:

1.1. **Parukeri; Niveli III sipas KKK,**

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- 2.1 Hartimi i politikave dhe procedurave të sistemit për sigurimin e materialeve të mësimdhënies dhe të dosjeve të kandidatëve të qendrës dhe evidentimi elektronike i tyre.
- 2.2 Plan-ndjekje operative dhe zëvendësim në vazhdimësi të materialeve të gjendjes aktuale të mjeteve, veglave dhe paisjeve të kandidateve të amortizuara.
- 2.3 Ofrimi i dëshmive për vlerësimin e performaces së stafit mësimdhënës.
- 2.4 Ri-rregullimi i sistemit të ngrohjes (Qendra në Ferizaj).
- 2.5 Trajnim i stafit dhe të kandidatëve për rregullat e ndihmës së shpejtë.
- 2.6 Trajnim në vazhdimësi i stafit dhe të kandidateve për rregullat e mbrojtjes kundër zjarrit dhe sigurisë.
- 2.7 Detyrimisht data e fillimit procesit mesimorë për gjithë kandidatëve të rregjistruar për cdo grup të ri të formuar të jetë unike.

- 2.8 Integrimi i nje specialist (eksperti) të jashtëm nga biznesi ne komisionin e vleresimit në testin perfundimtar teoriko-praktik, do te riste më tej standardin e vlerësimit të kandidatit.
- 2.9 Të zhvillohet një modul i cili i siguron kandidatit njohuri mbi higjenen, sjelljen ne pritje të klienteve.
- 2.10 Qendra duhet të ketë një procedurë të shkruar informues ne dosjen e kandidatit për mënyrën e menaxhimit të cilësisë së certifikimit, rastet e ankimimit, rastet kur kandidati kërkon një certifikatë të dytë (pas humbjes).
- 2.11 Paisja e kandidatit me certificate shtesë që permbanë informacion mbi kompetecat profesionale që ka perfituar kandidati gjatë periudhes së trajnimit si dhe disa rregulla bazë organizative teoriko-praktike tek qendra.
- 2.12 Qendra të zhvillon rregullore për njohjen dhe transferin e kredive.
- 2.13 Qendra të zhvillon dhe zbaton një dokument me politika zhvillimore të stafit.
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën **30.04.2017**, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kriteret, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.


Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:

- American Beauty;
- AKK.



Anëtar i KD së AKK-së
Bedri Xhafa